



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1300 Prot.

Roskovec, më 18.02 2023

VENDIM

NR 14 .DATË 27.02 2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN SHKURT 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 03.02.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, mbledhje jashtë radhe, për muajin Shkurt 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Kadri Hyska**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 738/1 Prot.

Roskovec, më 03.02.2023

**Procesverbal Nr.2**

*-I mbajtur sot, date 03.02.2023, ora 14<sup>00</sup>, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje jashte radhe e thirrur me kerkese te Kryetares se Bashkise, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
3. Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023.

Ora e hapjes se mbledhjes: 14<sup>05</sup>

Keshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, L.Hoxha, L.Goga, K.Hyska, G.Hoxha, V.Bakaj, A.Sheme, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Keshilltaret qe mungojne  
:E.Cepele, Rr.Hazizi, B.Cobo, B.Kuka, T.Kuka, A.Hazizi, D.Hoxha, V.Dogani.

Prezent nga bashkia: Kryetarja e bashkise M.Bufi, Dr.Ekonomise Selman Cepele.

Me plotesimin e kuorumit ,kryetari hap mbledhjen.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 11 keshilltare.Kryetari i falenderon keshilltaret per gadishmerine e treguar sot per kete mbledhje,pasi situata eshte vertet emergjente sepse nje shi te bjeri rrezikohen banesat nga shkarja e dheut ne kete zone te fshatit Vlosh.Edhe Kryetarja e Bashkise M.Bufi i falenderon keshilltaret per pjesmarrjen e tyre.Kryetari fillon mbledhjen.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro.

2.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro.

3.Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2023.

Dr.finances sqaron projektin.Kryetarja-i kemi nisur informacion paraprak edhe Prefektit,situata eshte emergjente,pas miratimit te ketij fondi nga ana juaj,do e kalojme menjehere ne prokurim,sepse sa me shpejt te filloje puna aq me mire do jete,sepse pasojat pastaj do jene te pa imagjinueshme.Selmani-kerkojme miratimin e fondit nga fondi jone per 2023,se fondi i qeverise nuk ka ardhur akoma.Eshte nje nderhyrje shume e domosdoshme,sepse po te mos nderhyjme do te sjelli pasoja te tjera pastaj,prandaj kerkojme me insistim kete miratim dhe fillimin e punes per riparimin.Aleksander-perderisa eshte emergjente ku rrezikojne shtepi,nuk kemi pyetje ne kete

rast.Kadriu-prandaj e zhvilluam edhe mbledhjen sot,per arsye se eshte shume emergjente dhe nuk kishte mundesi qe te shtyhej.Alketi-pas kesaj,ne ate zone duhet te mbillen peme,shkurre.Hidhet ne votim projekt-vendimi i perdorimit te fondit te emergjencave civile per vitin 2023 sipas materjalit te paraqitur dhe miratohet unimisht me 11 vota pro.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**



**Kryetar**

**Kadri Hyska**

